
DIREKTIVË E KËSHILLIT 2009/156/KE, DATË 30 NËNTOR 2009, "PËR KËRKESAT E SHËNDETIT TË KAFSHËVE QË RREGULLOJNË LËVIZJEN DHE IMPORTIN E KAFSHËVE NJËTHUNDRAKE NGA VENDET E TRETA" (VERSION I KODIFIKUAR)

(Tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE-në)

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh traktatin themelues të Bashkimit Evropian dhe në veçanti nenin 37 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit,

Duke pasur parasysh opinionin e Parlamentit Evropian¹,

Meqë:

1. Direktiva e Këshillit 90/426/KEE, datë 26 qershor 1990, "Për kërkesat e shëndetit të kafshëve që rregullojnë lëvizjen dhe importin e kafshëve njëthundrake nga vendet e treta"² është ndryshuar disa herë në mënyrë thelbësore³. Për të qenë e qartë dhe e arsyetuar, direktiva në fjalë duhet të kodifikohet.

2. Duke qenë se kafshët njëthundrake janë kafshë të gjalla, ato janë përfshirë në listën e produkteve në shtojcën I të traktatit.

3. Për të garantuar zhvillimin racional të mbarështimit të kafshëve njëthundrake, duke rritur kështu produktivitetin në këtë sektor, duhet të vendosen rregulla në nivel BE-je që rregullojnë lëvizjen e këtyre kafshëve në shtetet anëtare.

4. Mbarështimi dhe rritja e kafshëve njëthundrake dhe në veçanti e kuajve, përfshihet përgjithësisht në sektorin e bujqësisë. Kjo veprimtari përbën një burim të ardhurash për një pjesë të popullsisë fermere.

5. Për të nxitur tregtinë e kafshëve njëthundrake brenda BE-së duhet të eliminohen pabarazitë për sa i përket kërkesave të shëndetit të kafshëve në shtetet anëtare.

6. Për të nxitur zhvillimin e harmonizuar të tregtisë brenda BE-së duhet të parashikohet një sistem në nivel BE-je për të rregulluar importet nga vendet e treta.

7. Duhet të rregullohen gjithashtu kushtet për lëvizjen në territorin vendas të kafshëve njëthundrake të regjistruara dhe të pajisura me dokument identifikimi.

8. Për të qenë objekt i tregtimit, kafshët njëthundrake duhet të përmbushin disa kërkesa të shëndetit të kafshëve në mënyrë që të shmanget përhapja e sëmundjeve infektive dhe ngjitëse. Duket veçanërisht e përshtatshme të parashikohet rajonalizimi i mundshëm i masave kufizuese.

9. Për të njëjtat arsye duhet të përcaktohen edhe kushtet e transportit, duke marrë parasysh kushtet për mirëqenien e kafshëve të përcaktuara në rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1/2005, datë 22 dhjetor 2004, "Për mbrojtjen e kafshëve gjatë transportit dhe operacioneve të tjera të ngjashme"⁴.

10. Për të garantuar përmbushjen e këtyre kushteve, duhet të hartohen dispozita për lëshimin e certifikatës shëndetësore nga veterineri zyrtar, e cila do të shoqërojë kafshët për në destinacionin e tyre.

11. Organizimi dhe ndjekja e kontrolleve që do të kryhen nga shteti anëtar i destinacionit dhe masat mbrojtëse që do të zbatohen janë përcaktuar në Direktivën e Këshillit 90/425/KEE, datë 26 qershor 1990, "Për kontrollet veterinarë dhe zooteknike të zbatueshme për tregtinë brenda Komunitetit të disa produkteve dhe kafshëve të gjalla, me qëllim plotësimin e tregut të brendshëm"⁵.

12. Duhet të hartohen dispozita për mundësinë e kryerjes së kontrolleve nga Komisioni. Këto kontrolle duhet të kryhen në bashkëpunim me autoritetet kompetente kombëtare.

13. Përcaktimi i dispozitave të BE-së të zbatueshme për importet nga vendet e treta kërkon hartimin e një liste të vendeve të treta ose pjesëve të tyre nga të cilat mund të importohen kafshë njëthundrake.

14. Zgjedhja e këtyre vendeve duhet të bazohet në kritere të një natyre të përgjithshme si gjendja shëndetësore e bagëtive, organizimi dhe kompetencat e shërbimeve veterinarë si dhe rregulloret shëndetësore në fuqi.

15. Gjithashtu, nuk duhet të autorizohet importi i kafshëve njëthundrake nga vendet e prekura nga sëmundjet infektive ose ngjitëse të kafshëve që përbëjnë rrezik për bagëtinë në BE ose nga vendet e lira nga sëmundja prej shumë pak kohësh. Të njëjtat vlerësime vlejné edhe për importet nga vendet e treta në të cilat kryhet vaksinimi kundër këtyre sëmundjeve.

16. Kushtet e përgjithshme të zbatueshme për importet nga vendet e treta duhet të plotësohen nga kushte të veçanta të hartuara në bazë të gjendjes shëndetësore në secilin prej tyre. Natyra teknike dhe shumëllojshmëria e kritereve nga të cilat varen këto kushte të veçanta kërkon që përcaktimi i tyre të bëhet me anë të një procedure të shpejtë dhe fleksibël në nivel BE-je për të cilën të bashkëpunojné ngushtësisht Komisioni dhe shtetet anëtare.

17. Paraqitja e një certifikate standarde të përbashkët gjatë importit të kafshëve njëthundrake është një mënyrë efikase për të vërtetuar zbatimin e rregullave të BE-së. Këto rregulla mund të përfshijnë dispozita të veçanta të cilat mund të ndryshojné në varësi të vendit të tretë të prekur dhe kjo duhet të merret parasysh gjatë hartimit të modeleve standarde të certifikatave.

18. Ekspertët veterinarë të Komisionit dhe shteteve anëtare, të caktuar nga Komisioni, duhet të mbajnë përgjegjësi për verifikimin e zbatimit të kërkesave të kësaj direktive, në veçanti nga vendet e treta.

19. Kontrollët e kryera gjatë importit duhet të identifikojnë origjinën dhe gjendjen shëndetësore të kafshëve njëhundrake.

20. Masat e nevojshme për zbatimin e kësaj direktive duhet të miratohen në përputhje me Vendimin 1999/468/KE të Këshillit të 28 qershorit 1999 që parashtron procedurat për ushtrimin e kompetencave zbatuese që i delegohen Komisionit⁶.

21. Kjo direktivë nuk cenon detyrimet e shteteve anëtare në lidhje me afatet kohore për transpozimin në legjislacionin e brendshëm të direktivave të përcaktuara në shtojcën V, pjesa B,

MIRATON KËTË DIREKTIVË:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Kjo direktivë përcakton kushtet e shëndetit të kafshëve për lëvizjen ndërmjet shteteve anëtare dhe importin nga vendet e treta të kafshëve të gjalla njëhundrake.

Neni 2

Për qëllimet e kësaj direktive përdoren përkufizimet e mëposhtme:

a) "fermë" është një stabiliment bujqësor apo stabiliment për stërvitjen e kafshëve, një stallë ose, në përgjithësi, çdo ambient ose strukturë në të cilën mbahen ose rriten kafshët njëhundrake, për çfarëdolloj qëllimi;

b) "kafshë njëhundrake" janë kafshët e egra ose të zbutura të llojit të kuajve (duke përfshirë zebtrat) ose gomarëve ose pasardhësit e kryqëzimeve të tyre;

c) "kafshë njëhundrake të regjistruara" janë të gjitha kafshët njëhundrake të regjistruara sipas përcaktimit të Direktivës së Këshillit 90/427/KEE, datë 26 qershor 1990, "Për kushtet zooteknike dhe gjenealogjike që rregullojnë tregtimin e kafshëve njëhundrake brenda Komunitetit"⁷, të cilat identifikohen me anë të një dokumenti identifikimi të lëshuar nga:

I. autoriteti i mbarështimit apo nga çdo autoritet tjetër kompetent në vendin e origjinës së kafshës, i cili menaxhon librin gjenealogjik ose regjistrin e kësaj race ose kafshe; ose

II. shoqatë ose organizatë ndërkombëtare që mban kuaj për konkurse ose gara;

d) "kafshë njëhundrake për therje" janë kafshë njëhundrake të destinuar për t'u transportuar drejtpërdrejtë ose pas transitit nëpërmjet një qendre grumbullimi të miratuar, të përmendur në nenin 7, në thertore për therje;

e) "kafshë njëthundrake për mbarështim dhe prodhim" janë kafshët njëthundrake të ndryshme nga ato të përmendura në germën "c" dhe "d";

f) "shtet anëtar ose vend i tretë i liruar nga sëmundja afrikane e kuajve" janë të gjitha shtetet anëtare ose vendet e treta në territorin e të cilave nuk ka pasur shfaqje klinike, serologjike (në kafshët njëthundrake të pavaksinuara) ose epidemiologjike të sëmundjes afrikane të kuajve gjatë dy viteve të kaluara dhe në të cilat nuk janë kryer vaksinime kundër kësaj sëmundjeje gjatë 12 muajve të kaluar;

g) "sëmundje detyrimisht të lajmërueshme" janë sëmundjet e renditura në shtojcën I;

h) "veteriner zyrtar" është veterineri i caktuar nga autoriteti kompetent qendror i një shteti anëtar ose i një vendi të tretë;

i) "pranim i përkohshëm" është statusi i kafshëve njëthundrake të regjistruara që vijnë nga një vend i tretë dhe që pranohen në territorin e BE-së për një periudhë prej më pak se 90 ditësh që caktohet në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 21, paragrafi 2, në varësi të gjendjes shëndetësore në vendin e origjinës.

KREU II

RREGULLAT PËR LËVIZJEN E KAFSHËVE NJËTHUNDRAKE NDËRMJET SHTETEVE ANËTARE

Neni 3

Shtetet anëtare autorizojnë lëvizjen në territorin e tyre të kafshëve njëthundrake të regjistruara ose i dërgojnë këto të fundit në një shtet tjetër anëtar vetëm nëse ato i përmbushin kushtet e përcaktuara në nenin 4 dhe 5.

Megjithatë, autoritetet kompetente në shtetet anëtare të destinacionit mund të lejojnë përjashtime të përgjithshme ose të kufizuara në lidhje me lëvizjen e kafshëve njëthundrake të cilat:

— të cilat drejtohen ose merren për qëllime sportive ose argëtimi, përgjatë rrugëve pranë kufijve të brendshëm të BE-së,

— marrin pjesë në ngjarje kulturore ose të ngjashme apo në aktivitete të organizuara nga organet e autorizuara vendore që ndodhen pranë kufijve të brendshëm të BE-së,

— janë të destinuara vetëm për kullotje ose punë të përkohshme pranë kufijve të brendshëm të BE-së,

Shtetet anëtare që shfrytëzojnë këtë autorizim informojnë Komisionin për përmbajtjen e përjashtimeve të lejuara.

Neni 4

1. Gjatë kontrollit, kafshët njëhundrake nuk duhet të paraqesin asnjë shenjë klinike për sëmundje. Kontrolli duhet të kryhet gjatë 48 orëve para hipjes në anije ose para ngarkimit. Megjithatë, pa cenuar nenin 6, në rastin e kafshëve njëhundrake të regjistruara ky kontroll është i nevojshëm vetëm për tregtinë brenda BE-së.

2. Pa cenuar kërkesat e paragrafit 5 në lidhje me sëmundjet detyrimisht të lajmërueshme, gjatë kontrollit, veterineri zyrtar duhet të garantojë që nuk ka arsye, në veçanti duke u bazuar tek deklaratat e pronarit apo mbarështuesit, për të dalë në përfundimin se kafshët njëhundrake kanë rënë në kontakt me njëhundurakë me sëmundje infektive ose ngjitëse gjatë 15 ditëve menjëherë pas kontrollit.

3. Sipas programit kombëtar për zhdukjen e sëmundjeve infektive ose ngjitëse, kafshët njëhundrake nuk duhet të përdoren për qëllime therjeje.

4. Kafshët njëhundrake duhet të identifikohen sipas mënyrës së mëposhtme:

a) në rastin e kafshëve njëhundrake të regjistruara, me anë të një dokumenti identifikimi, siç parashikohet në Direktivën 90/427/KEE, i cili duhet të vërtetohet në veçanti përputhjen me paragrafët 5 dhe 6 të këtij neni dhe nenin 5 të kësaj direktive.

Veterineri zyrtar duhet të pezullojë vlefshmërinë e dokumentit të identifikimit gjatë periudhës së ndalimeve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni ose në nenin 5 të kësaj direktive. Pas therjes së kalit të regjistruar, dokumenti i identifikimit duhet t'i kthehet autoritetit që e ka lëshuar. Procedura për zbatimin e kësaj germe miratohet në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 21 paragrafi 2;

b) në rastin e kafshëve njëhundrake për mbarështim ose prodhim, me anë të metodës së përcaktuar në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 21 paragrafi 2.

5. Një tjetër kërkesë përveç atyre të përcaktuara në nenin 5, është se kafshët njëhundrake nuk duhet të kenë ardhur nga një fermë që ka qenë objekt i një prej urdhrave të mëposhtme të ndalimit:

a) nëse nuk janë therur të gjitha kafshët e fermës që i përkasin specieve të ndjeshme ndaj sëmundjes, periudha e ndalimit për fermën e origjinës duhet të jetë të paktën:

I. gjashtë muaj në rastin e kafshëve njëhundrake që dyshohen të jenë prekur nga durina, duke filluar nga data e kontaktit të fundit konkret ose të mundshëm me një kafshë të sëmurë. Megjithatë, në rastin e hamshorëve, ndalimi është i vlefshëm deri në tredhjen e kafshës;

II. gjashtë muaj në rastin e kërrnjotës ose encefalomielit të kuajve, duke filluar nga dita e therjes së kafshëve njëhundrake të prekura nga sëmundja;

III. në rastin e anemisë infektive, deri kur, pas therjes së kafshëve të infektuara, ato që kanë mbetur të kenë rezultuar negative në dy testet Coggins të kryera në një distancë prej tre muajsh;

IV. gjashtë muaj nga rasti i fundit i regjistruar me stomatit vezikular;

V. një muaj nga rasti i fundit i regjistruar me tërbim;

VI. 15 ditë nga rasti i fundit i regjistruar me antraks;

b) nëse janë therur të gjitha kafshët e fermës që i përkasin specieve të ndjeshme ndaj sëmundjes dhe nëse janë dezinfektuar ambientet, periudha e ndalimit zgjat 30 ditë duke filluar nga dita e asgjësimit të kafshëve dhe dezinfektimit të ambienteve, me përjashtim të rastit të antraksit, ku periudha e ndalimit zgjat 15 ditë.

Autoritetet kompetente mund të derogojnë nga këto urdhra ndalimi në rastin e hipodromeve dhe pistave të garave dhe njoftojnë Komisionin për natyrën e derogimeve të lejuara.

6. Në rastin kur një shtet anëtar harton ose ka hartuar një program vullnetar ose të detyrueshëm kontrolli për një sëmundje ndaj të cilës kafshët njëthundrake janë të ndjeshme, ai mund t'ia paraqesë programin Komisionit, brenda gjashtë muajve duke nisur nga 4 korriku 1990 për Belgjikën, Danimarkën, Gjermaninë, Irlandën, Greqinë, Spanjën, Francën, Italinë, Luksemburgun, Holandën, Portugalinë dhe Mbretërinë e Bashkuar, nga 1 janari 1995 për Austrinë, Finlandën dhe Suedinë, nga 1 maji 2004 për Republikën Çeke, Estoninë, Qipron, Letoninë, Lituaninë, Hungarinë, Maltën, Poloninë, Slloveninë dhe Sllovakinë dhe nga 1 janari 2007 për Bullgarinë dhe Rumaninë, duke nënvizuar në veçanti:

a) përhapjen e sëmundjes në territorin e tij;

b) arsyet për këtë program, duke marrë në konsideratë rëndësinë e sëmundjes dhe avantazhet e kosto/përfitimit;

c) zonën gjeografike në të cilën do të zbatohet programi;

d) statutet e ndryshme të zbatueshme për stabilimentet, standardet që duhet të arrihen për çdo specie dhe procedurat e testimi që do të përdoren;

e) procedurat e monitorimit të programit;

f) veprimin që do të ndërmerret nëse, për çfarëdo arsye, ferma humb statusin e saj;

g) masat që do të merren nëse rezultatet e testeve të kryera në përputhje me dispozitat e programit janë pozitive;

h) natyrën jodiskriminuese të tregtisë në territorin e shtetit anëtar në fjalë në lidhje me tregtinë brenda BE-së.

Komisioni shqyrton programet e paraqitura nga shtetet anëtare. Sipas rastit, ai i miraton ato në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 21, paragrafi 2. Çdo garanci shitesë, e përgjithshme ose specifike, që mund të jetë e nevojshme për tregtinë brenda BE-së mund të përcaktohet në përputhje me të njëjtën procedurë. Këto garanci nuk duhet t'i tejkalojnë ato që shteti anëtar kërkon në territorin e tij.

Programet e paraqitura nga shtetet anëtare mund të ndryshohen ose të plotësohen në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 21, paragrafi 3. Sipas së njëjtës procedurë mund të miratohen ndryshime apo shtesa për programet e miratuara tashmë ose për garancitë e përcaktuara në përputhje me nënparagrafin e dytë.

Neni 5

1. Një shtet anëtar që nuk është liruar nga sëmundja afrikane e kuajve mund t'i largojë kafshët njëhundra nga ajo pjesë e territorit të tij që konsiderohet e infektuar, sipas kuptimit të paragrafit 2 të këtij neni, vetëm nëse respekton kushtet e përcaktuara në paragrafin 5.

2. Një pjesë e territorit të një shteti anëtar konsiderohet e infektuar me sëmundjen afrikane të kuajve nëse:

a) gjatë dy viteve të kaluara, shfaqjet klinike, serologjike (tek kafshët e pavaksinuara) dhe/ose epidemiologjike kanë dëshmuar praninë e sëmundjes afrikane të kuajve; ose

b) është kryer vaksinimi kundër sëmundjes afrikane të kuajve gjatë 12 muajve të kaluar.

Pjesa e territorit që konsiderohet të jetë e infektuar me sëmundjen afrikane të kuajve përfshin minimalisht:

a) një zonë të mbrojtur me një rreze prej të paktën 100 km rreth çdo qendre të infektuar;

b) një zonë mbikëqyrjeje prej të paktën 50 km që shtrihet përtej zonës së mbrojtur, në të cilën nuk janë kryer vaksinime gjatë 12 muajve të fundit.

3. Rregullat e kontrollit dhe masat për luftimin e sëmundjes afrikane të kuajve në lidhje me territoret dhe zonat e përmendura në paragrafin 2 dhe derogimet përkatëse specifikohen në Direktivën e Këshillit 92/35/KEE, datë 29 prill 1992, "Për përcaktimin e rregullave të kontrollit dhe masave për luftimin e sëmundjes afrikane të kuajve"⁸.

4. Të gjitha kafshët njëhundra të vaksinuara që gjenden në zonën e mbrojtur duhet të regjistrohen dhe të shënohen në përputhje me nenin 6, paragrafi 1, germa "d" të Direktivës 92/35/KEE.

Dokumenti i identifikimit dhe/ose certifikata shëndetësore kanë një referencë të qartë të vaksinimit.

5. Një shtet anëtar mund të bëjë dërgesa nga territori i përmendur në nënparagrafin e dytë, vetëm të kafshëve njëhundra që përmbushin kërkesat e mëposhtme:

a) duhet të nisen vetëm në periudha të caktuara të vitit, sipas veprimtarisë së insekteve vektor, që do të përcaktohen në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 21, paragrafi 3;

b) nuk duhet të shfaqin simptoma klinike të sëmundjes afrikane të kuajve në ditën e inspektimit të përmendur në nenin 4, paragrafi 1;

c) duhet t'i jenë nënshtruar një testi për sëmundjen afrikane të kuajve siç përshkruhet në shtojcën IV, dy herë, me një interval prej 21 deri në 30 ditësh midis dy testeve, ku i dyti duhet të jetë kryer gjatë 10 ditëve para nisjes, ose:

I. me rezultate negative, nëse nuk janë vaksinuar kundër sëmundjes afrikane të kuajve; ose

II. pa shenja të rritjes së antitropave dhe pa ju nënshtruar vaksinimit gjatë dy muajve të kaluar, nëse janë vaksinuar kundër sëmundjes afrikane të kuajve.

Në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 21, paragrafi 2 dhe pas opinionit të Autoritetit Evropian të Sigurisë Ushqimore, mund të njihen metoda të tjera monitorimi;

d) kafshët duhet të jenë mbajtur në një stacion karantine për një periudhë minimale prej 40 ditësh para nisjes;

e) ato duhet të kenë qenë të mbrojtura nga insektet vektor gjatë periudhës së karantinës dhe gjatë transportit nga stacioni i karantinës në vendin e dërgimit.

Neni 6

Shtetet anëtare që zbatojnë një sistem alternativ kontrolli që ofron garanci të barasvlershme me ato të përcaktuara në nenin 4, paragrafi 5 në lidhje me lëvizjen e kafshëve njëthundrake brenda territorit të tyre, mund t'i lejojnë njëri-tjetrit, në mënyrë reciproke, derogime nga dispozitat e fjalisë së dytë të paragrafit 1 të nenit 4 dhe të germës "b" të paragrafit 1 të nenit 8.

Shtetet anëtare njoftojnë Komisionin për to.

Neni 7

1. Kafshët njëthundrake duhet të transportohen nga ferma e origjinës, sa më shpejt të jetë e mundur, direkt ose nëpërmjet një qendre të miratuar, të përcaktuar si "qendër grumbullimi" në nenin 2, paragrafi 2, germa "o" të Direktivës së Këshillit 64/432/KEE, datë 26 qershor 1964, "Për problemet e shëndetit të kafshëve që ndikojnë në tregtinë brenda BE-së të kafshëve të llojit gjedh dhe derr"⁹, në vendin e destinacionit me mjete ose kontejnerë që janë pastruar dhe dezinfektuar rregullisht me dezinfektues në intervale që do të përcaktohen nga shteti anëtar i nisjes. Mjetet duhet të ndërtohen në mënyrë të tillë që mbeturinat, mbetjet ose tagjia e kafshëve njëthundrake të mos bien nga mjete gjatë transportit. Pa cenuar rregulloren (KE) nr. 1/2005, transporti duhet të kryhet në mënyrë të tillë që të ruhet në mënyrë efektive gjendja shëndetësore dhe mirëqenia e kafshëve njëthundrake.

2. Shteti anëtar i destinacionit mundet, në mënyrë të përgjithshme ose të kufizuar, të lejojë derogime nga disa prej kërkesave të nenit 4, paragrafi 5 për çdo kafshë që mban një shenjë të veçantë që tregon se do të theret, me kusht që këto derogime të përmenden në certifikatën shëndetësore në përputhje me shtojcën III.

Në rast se këto derogime lejohen, kafshët njëthundrake për therje duhet të transportohen direkt në thertoren e caktuar dhe të theren brenda pesë ditësh nga mbërritja aty.

3. Veterineri zyrtar duhet të regjistrojë numrin e identifikimit ose numrin e dokumentit të identifikimit të kafshës së therur dhe ti përcjellë autoritetit kompetent të vendit të dërgimit, me kërkesë të këtij të fundit, një vërtetim me qëllim informimin e therjes së kafshës.

Neni 8

1. Shtetet anëtare garantojnë që:

a) kafshët e therura njëthundrake që largohen nga fermat e tyre të shoqërohen nga dokumenti i identifikimit i përcaktuar në nenin 4, paragrafi 4, germa "a" së bashku me, nëse do të tregtohen brenda BE-së, me vërtetimin shëndetësor të parashikuar në shtojcën II;

b) kafshët njëthundrake për mbarështim, prodhim dhe therje të shoqërohen, gjatë transportit, nga një certifikatë shëndetësore që përputhet me shtojcën III.

2. Certifikata shëndetësore, ose në rastin e kafshëve të regjistruara njëthundrake, vërtetimi shëndetësor, pa cenuar nenin 6, duhet të hartohen gjatë 48 orëve para hipjes së kafshëve ose në të kundërt jo më vonë se dita e fundit e punës para saj, në të paktën një prej gjuhëve zyrtare të shteteve anëtare dërguese dhe të destinacionit. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së certifikatës ose vërtetimit shëndetësor është 10 ditë. Certifikata ose vërtetimi shëndetësor duhet të përbëhen nga një fletë e vetme.

3. Për lëvizjen midis shteteve anëtare, kafshët njëthundrake jo të regjistruara mund të mbulohen nga një certifikatë e vetme shëndetësore për dërgesë dhe jo nga certifikata shëndetësore individuale e përmendur në paragrafin 1, germa "b".

Neni 9

Rregullat e përcaktuara në Direktivën 90/425/KEE zbatohen në veçanti për kontrollet në vendin e origjinës, për organizimin dhe rezultatet e kontrolleve të kryera nga shteti anëtar i destinacionit dhe për masat mbrojtëse që do të zbatohen.

Neni 10

Ekspertët veterinarë nga Komisioni mund të kryejnë inspektime në terren, në masën që është e nevojshme për të garantuar zbatimin uniform të kësaj direktive, në bashkëpunim me autoritetet kompetente kombëtare. Komisioni informon shtetet e tjera anëtare për rezultatin e këtyre inspektimeve.

Shtetet anëtare në territorin e të cilave kryhet inspektimi i japin ekspertit të gjithë ndihmën e nevojshme për të kryer detyrën e tyre.

Masat e përgjithshme për zbatimin e këtij neni miratohen sipas procedurës të përmendur në nenin 21, paragrafi 2.

KREU III

RREGULLA PËR IMPORTIN E KAFSHËVE NJËTHUNDRAKE NGA VENDET E TRETË

Neni 11

Kafshët njëthundrake të importuara në BE duhet të përmbushin kushtet e përcaktuara në nenet 12 deri në 16.

Neni 12

1. Importi i kafshëve njëthundrake në BE autorizohet vetëm nga vendet e treta që bëjnë pjesë një listën që do të hartohet ose ndryshohet në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 21, paragrafi 2.

Duke marrë parasysh gjendjen shëndetësore dhe garancitë e dhëna nga vendi i tretë për kafshët njëthundrake, në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 21, paragrafi 2 mund të vendoset që autorizimi i parashikuar në nënparagrafin e parë të këtij paragrafi të zbatohet për të gjithë territorin e vendit të tretë ose vetëm një pjesë të tij.

Për këtë qëllim dhe në bazë të standardeve ndërkombëtare përkatëse, duhet të merret parasysh mënyra se si vendi i tretë i zbaton dhe i implementon këto standarde, në veçanti parimin e rajonalizimit, brenda territorit të vetë dhe në lidhje me kushtet e tij sanitare për importin nga vendet e treta dhe nga BE-ja.

2. Kur lista e parashikuar në paragrafin 1 hartohet dhe ndryshohet, merret parasysh, në veçanti:

a) gjenda shëndetësore e kafshëve njëthundrake, kafshëve të tjera shtëpiake dhe kafshëve të egra në vendin e tretë, veçanërisht duke pasur parasysh sëmundjet ekzotike të kafshëve dhe çdo aspekt të gjendjes së përgjithshme shëndetësore dhe mjedisore në vendin e tretë, që mund të përbëjë rrezik për gjendjen shëndetësore dhe mjedisore të BE-së;

b) legjislacioni i vendit të tretë në raport me shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve;

c) organizimi i autoritetit kompetent veterinar dhe shërbimeve të tij të inspektimit, kompetenca e këtyre shërbimeve, mbikëqyrja të cilës i nënshtrohen dhe mjetet në dispozicion, duke përfshirë kapacitetin e stafit dhe atë laboratorik, për të zbatuar legjislacionin në mënyrë efikase;

d) siguritë që autoriteti kompetent veterinar i vendit të tretë mund të japë në lidhje me përputhshmërinë ose ekuivalencën me kushtet përkatëse të shëndetit të kafshëve të zbatueshme në BE;

e) nëse vendi i tretë është anëtar i Organizatës Botërore për Shëndetin e Kafshëve (OIE) si dhe rregullsinë dhe shpejtësinë e informacionit të ofruar nga vendi i tretë në lidhje me ekzistencën e sëmundjeve infektive ose ngjitëse të kafshëve njëthundrake në territorin e tij, në veçanti ato sëmundje të renditura nga OIE dhe në shtojcën I të kësaj direktive;

f) garancitë e dhëna nga vendi i tretë për të informuar drejtpërdrejtë Komisionin dhe shtetet anëtare:

I. brenda 24 orësh, për konfirmimin e rasteve të sëmundjeve infektive të kafshëve njëthundrake të renditura në shtojcën I dhe për çdo ndryshim në politikën e vaksinimit të këtyre sëmundjeve;

II. brenda një periudhe të përshtatshme, për çdo ndryshim të propozuar në rregullat kombëtare sanitare për sa i përket kafshëve njëthundrake, në veçanti në lidhje me importin e kafshëve njëthundrake;

III. në intervale të rregullta, për gjendjen shëndetësore të kafshëve të territorit të tij për sa i përket kafshëve njëthundrake;

g) çdo përvojë e importeve të mëparshme të kafshëve të gjalla njëthundrake nga vendi i tretë dhe rezultatet e kontrolleve të kryera të importeve;

h) rezultatet e inspektimeve të BE-së dhe/ose kontrollet e kryera në vendin e tretë, në veçanti rezultatet e vlerësimit të autoriteteve kompetente ose, kur e kërkon Komisioni, raporti i dorëzuar nga autoritetet kompetente për inspektimet që kanë kryer;

i) rregullat në fuqi në vendin e tretë për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve infektive të kafshëve dhe zbatimin e tyre, duke përfshirë rregullat për importin e kafshëve njëthundrake nga vende të tjera të treta.

3. Komisioni merr masa për vënien në dispozicion të publikut të versioneve të përditësuara të listës së hartuar ose të ndryshuar siç parashikohet në paragrafin 1.

Lista mund të kombinohet me lista të tjera të hartuara për qëllime të mbrojtjes së shëndetit publik dhe të kafshëve dhe mund të përfshijë gjithashtu modele të certifikatave shëndetësore.

4. Kushtet e veçanta të importit për çdo vend të tretë ose grup të vendeve të treta, për sa i përket gjendjes së shëndetit të kafshëve në lidhje me njëthundrakët në vendin ose vendet e treta në fjalë, përcaktohen në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 21, paragrafi 2.

5. Rregullat e detajuara për zbatimin e paragrafëve 1 deri në 4 dhe kriteret për përfshirjen e vendeve të treta ose disa pjesëve të vendeve të treta në listën e parashikuar në paragrafin 1, mund të miratohen në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 21, paragrafi 2.

Neni 13

1. Kafshët njëthundrake duhet të vijnë nga vende të treta të cilat:

a) janë liruar nga sëmundja afrikane e kuajve;

b) janë liruar nga encefalomieli venezuelan i kuajve (VEE) që prej dy vjetësh;

c) janë liruar nga durina dhe kërrnjota prej gjashtë muajsh.

2. Në përputhje me procedurat e përmendura në nenin 21, paragrafi 2 mund të merret vendimi:

a) që dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni të zbatohen vetëm për një pjesë të territorit të vendit të tretë.

Në rast se kërkesat e sëmundjes afrikane të kuajve zbatohen në shkallë rajonale, të paktën masat e përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2 dhe 5 duhet të respektohen;

b) për të kërkuar garanci të tjera për sëmundjet e panjohura në BE.

Neni 14

Para ditës së ngarkesës për transport në shtetin anëtar të destinacionit, kafshët njëthundrake duhet të kenë qëndruar pa ndërprerje në territorin ose një pjesë të territorit të vendit të tretë ose, në rast të rajonalizimit, në pjesën e territorit të përcaktuar në nenin 13, paragrafi 2, germa "a" për një periudhë që do të përcaktohet në vendimet që do të miratohen sipas nenit 15.

Ato duhet të vijnë nga një fermë që ka qenë nën mbikëqyrje veterinare.

Neni 15

Importi i kafshëve njëthundrake nga territori i një vendi të tretë ose nga një pjesë e tij siç përcaktohet në përputhje me nenin 13, paragrafi 2, germa "a" në listën e hartuar në përputhje me nenin 12, paragrafi 1 autorizohet vetëm nëse kafshët njëthundrake, mbi kërkesat e nenit 13:

a) përmbushin kërkesat e miratuara të shëndetit të kafshëve, në lidhje me speciet në fjalë, kategoritë e kafshëve njëthundrake, në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 21, paragrafi 2 për importin e kafshëve njëthundrake nga ai vend.

Baza e referencës për përcaktimin e këtyre kushteve të shëndetit të kafshëve janë standardet e përcaktuara në nenin 4 dhe 5; dhe

b) në rastin e një vendi të tretë jo të liruar nga stomatiti vezikular ose artriti viral për të paktën gjashtë muaj, kafshët njëthundrake duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme:

I. ato duhet të vinë nga një fermë e liruar nga stomatiti vezikular për të paktën gjashtë muajt e fundit dhe duhet të kenë reaguar negativisht ndaj testit serologjik të kryer para nisjes;

II. në rastin e artritit viral, njëthundrakët meshkuj, pavarësisht nenit 19, paragrafi b, duhet të kenë reaguar negativisht ndaj testit serologjik, ndaj testit të izolimit të virusit ose ndaj çdo testi tjetër që njihet në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 21, paragrafi 2 që do të garantonin që janë të paprekur nga virusi.

Në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 21, paragrafi 2 dhe pas opinionit të Autoritetit Evropian të Sigurisë Ushqimore, duhet të përcaktohen kategoritë e njëhundurakëve meshkuj për të cilët zbatohet kjo kërkesë.

Neni 16

1. Kafshët njëhundurake duhet të identifikohen në përputhje me nenin 4, paragrafi 4 dhe të shoqërohen nga një certifikatë shëndetësore e hartuar nga një veteriner zyrtar i vendit të tretë eksportues. Kjo certifikatë shëndetësore duhet:

a) të lëshohet ditën e ngarkimit të kafshëve që do të nisen në shtetin anëtar të destinacionit ose, në rastin e kuajve të regjistruar, ditën e fundit të punës para hipjes në anije;

b) të hartohet në të paktën një prej gjuhëve zyrtare të shtetit anëtar të destinacionit dhe në një prej gjuhëve të shtetit anëtar në të cilin kryhet inspektimi i importit;

c) të shoqërojë kafshët në gjendjen fillestare;

d) të vërtetojë që kafshët përmbushin kërkesat e kësaj direktive dhe ato të përcaktuara sipas kësaj direktive për sa i përket importit nga vendet e treta;

e) të përbëhet nga një fletë e vetme;

f) të jetë lëshuar vetëm për një marrës ose në rastin e kafshëve për therje, për një dërgesë, me kusht që kafshët të jenë shënuar dhe identifikuar në mënyrën e duhur.

Shtetet anëtare informojnë Komisionin nëse përdorin këtë opsion.

2. Certifikata e shëndetit të kafshëve duhet të hartohet sipas formularit të një modeli të caktuar në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 21, paragrafi 2.

Neni 17

1. Menjëherë pas mbërritjes në shtetin anëtar të destinacionit, kafshët njëhundurake për therje dërgohen një një thertore, direkt ose pas kalimit në një qendër grumbullimi të miratuar, siç përmendet në nenin 7 dhe, në përputhje me kërkesat e shëndetit të kafshëve, theren brenda një periudhe të caktuar në vendimet që do të miratohen sipas nenit 15.

2. Pa cenuar asnjë nga kushtet e veçanta që mund të miratohen në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 21, paragrafi 2, autoriteti kompetent i shtetit anëtar të destinacionit, për arsye të shëndetit të kafshëve, mund të përcaktojë thertoren ku do të dërgohen këto kafshë njëhundurake.

Neni 18

Kontrollet kryhen në terren nga ekspertët veterinarë të shteteve anëtare dhe të Komisionit për të verifikuar nëse dispozitat e kësaj direktive dhe në veçanti ato të nenit 12, paragrafi 2, po zbatohen në praktikë.

Nëse kontrollet e kryera sipas kushteve të këtij neni nxjerrin në pah fakte serioze ndaj një ferme të miratuar, Komisioni informon menjëherë shtetet anëtare dhe miraton një vendim që e pezullon përkohësisht miratimin. Vendimi përfundimtar merret në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 21, paragrafi 3.

Ekspertët e shteteve anëtare të cilëve do t'u besohen këto kontrolle emërohen nga Komisioni, me propozim nga vetë shtetet anëtare.

Këto kontrolle kryhen në emër të BE-së e cila mbulon koston e çdo shpenzimi përkatës.

Shpeshësia dhe procedura për kryerjen e këtyre kontrolleve përcaktohet në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 21, paragrafi 2.

Neni 19

Në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 21, paragrafi 2:

a) mund të vendosi që të kufizohet importi nga një vend i tretë ose nga një pjesë e këtij vendi për specie ose kategori të caktuara të kafshëve njëthundrake;

b) pavarësisht nenit 15, përcakton kushtet e veçanta për hyrjen e përkohshme në territorin e BE-së të kafshëve njëthundrake të regjistruara apo të synuara për përdorime të veçanta ose për rihyrjen e tyre në BE pasi janë eksportuar përkohësisht;

c) përcakton kushtet për ta kthyer hyrjen e përkohshme në të përhershme;

d) mund të përcaktojë një laborator referencë të BE-së për një ose më shumë sëmundje të kafshëve njëthundrake të renditura në shtojcën I dhe parashikon funksionet, detyrat dhe procedurat në lidhje me bashkëpunimin me laboratorët përgjegjës për diagnostikimin e sëmundjeve infektive të kafshëve njëthundrake në shtetet anëtare.

KREU IV

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 20

Shtojcat I deri në IV ndryshohen në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 21, paragrafi 3.

Neni 21

1. Komisioni mbështetet nga Komiteti i Përhershëm për Zinxhirin Ushqimor dhe Shëndetin e Kafshëve, i ngritur sipas nenit 58 të Rregullores (KE) nr. 178/2002 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 28 janar 2002, "Për përcaktimin e parimeve të përgjithshme dhe kërkesave të legjislacionit për ushqimin, krijimin e Autoritetit Evropian të Sigurisë së Ushqimeve dhe përcaktimin e procedurave për çështjet e sigurisë së ushqimeve"¹⁰.

2. Aty ku përmendet ky paragraf, gjejnë zbatim nenet 5 dhe 7 të vendimit 1999/468/KE.

Periudha e përcaktuar në nenin 5, paragrafi 6 të vendimit 1999/468/KE është tre muaj.

3. Aty ku përmendet ky paragraf, gjejnë zbatim nenet 5 dhe 7 të vendimit 1999/468/KE.

Periudha e përcaktuar në nenin 5 paragrafi 6 të Vendimit 1999/468/KE caktohen në intervale 15 ditore.

Neni 22

Direktiva 90/426/KEE e ndryshuar nga aktet e renditura në shtojcën V, pjesa A, shfuqizohet pa cenuar detyrimet e shteteve anëtare në lidhje me afatet kohore për transpozimin në legjislacionin e brendshëm të direktivave të përcaktuara në shtojcën V, pjesa B.

Referencat për direktivën e shfuqizuar interpretohen si referenca për këtë direktivë dhe shpjegohen në përputhje me tabelën e përputhshmërisë në shtojcën VI.

Neni 23

Kjo direktivë hyn në fuqi 20 ditë pas botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Neni 24

Kjo direktivë u drejtohet shteteve anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 30 nëntor 2009.

Për Këshillin

Presidenti

S. O. LITTORIN

SHTOJCA I

SËMUNDJET DETYRIMISHT TË LAJMËRUESHME

Sëmundjet e mëposhtme janë sëmundje detyrimisht të lajmërueshme:

— Durina

— Kërronjtë

— Encefalomieli i kuajve (i të gjitha llojeve, duke përfshirë VEE-në)

— Anemia infektive

— Tërbimi

- Antraksi
- Sëmundja afrikane e kuajve;
- Stomatiti vezikular

SHTOJCA II

MODELI

VËRTETIMI SHËNDETËSOR¹¹

Nr. i Pasaportës ...

Unë, i nënshkruari, vërtetoj se¹² kafsha e identifikuar më sipër përmbush kërkesat e mëposhtme:

- a) është ekzaminuar sot dhe nuk paraqet asnjë shenjë klinike sëmundjeje;
- b) nuk është i destinuar për therje në kuadër të një programi kombëtar për zhdukjen e sëmundjeve ngjitëse ose infektive;
- c) — nuk vjen nga territori ose pjesë e territorit të shtetit anëtar që është objekt i kufizimeve për shkak të sëmundjes afrikane të kuajve, ose

vjen nga territori ose pjesë e territorit të një shteti anëtar që ishte objekt i ndalimit për arsye të shëndetit të kafshëve dhe i është nënshtruar, me rezultate pozitive, testeve të parashikuara në nenin 5, paragrafi 5 të Direktivës 2009/156/KE në stacionin karantinor të ...midis ... dhe ...¹³

- nuk është e vaksinuar kundër sëmundjes afrikane të kuajve, ose
- u vaksinuar kundër sëmundjes afrikane të kafshëve më ...¹³⁻¹⁴;

d) nuk vjen nga një fermë që ka qenë objekt i ndalimit për arsye të shëndetit të kafshëve dhe as nuk ka pasur kontakt me kafshët njëthundrake të një ferme që ka qenë objekt i ndalimit për arsye të shëndetit të kafshëve:

— për gjashtë muaj në rastin e kafshëve njëthundrake që dyshohen të jenë prekur nga durina, duke filluar nga data e kontaktit të fundit konkret ose të mundshëm me një kafshë të sëmurë. Megjithatë, në rastin e hamshorëve, ndalimi është i vlefshëm deri në tredhjen e kafshës,

— për gjashtë muaj në rastin e kërrnjotës ose encefalomielit të kuajve, duke filluar nga dita e therjes së kafshëve njëthundrake të prekura nga sëmundja,

— në rastin e anemisë infektive, deri kur, pas therjes së kafshëve të infektuara, ato që kanë mbetur të kenë rezultuar negative në dy testet Coggins të kryera në një distancë prej tre muajsh,

— për gjashtë muaj nga rasti i fundit i stomatitit vezikular,

— për një muaj nga rasti i fundit i tërbimit,

— për 15 ditë nga rasti i fundit i antraksit,

— për 30 ditë duke filluar nga dita e asgjësimit të kafshëve dhe dezinfektimit të ambienteve, nëse janë therur të gjitha kafshët e fermës që i përkasin specieve të ndjeshme ndaj sëmundjeve dhe nëse janë dezinfektuar ambientet, me përjashtim të rastit të antraksit, ku periudha e ndalimit zgjat 15 ditë;

e) në dijeninë time, nuk ka qenë në kontakt me kafshë njëthundrake që vuajnë nga një sëmundje infektive ose ngjitëse gjatë 15 ditëve para këtij deklarami;

f) në kohën e inspektimit ishte e përshtatshme për transport gjatë udhëtimit të parashikuar në përputhje me dispozitat e rregullores (KE) nr. 1/2005¹⁵.

Data Vendi Vula dhe nënshkrimi i veterinerit zyrtar¹⁶

SHTOJCA III

MODELI

CERTIFIKATË SHËNDETËSORE

Për tregtinë midis shteteve anëtare

Kafshët njëthundrake

SHTOJCA IV

SËMUNDJA AFRIKANE E KUAJVE

DIAGNOZA

Reagentët për metodën imunoenzimatiqe (ELISA) të përshkruar më poshtë mund të merren nga laboratorit referencë i BE-së ose nga laboratorët referencë të OIE-së për sëmundjen afrikane të kuajve.

1. ELISA KONKURRUESE PËR ZBULIMIN E ANTITRUPAVE NDAJ VIRUSIT TË SËMUNDJES AFRIKANE TË KUAJVE (AHSV) (TEST I DETYRUESHËM)

ELISA konkurruese përdoret për të zbuluar antitrupe specifike AHSV në serumet e të gjitha specieve të kafshëve njëhundra. Serumi poliklonal antikavie kundër AHSV-së (në vijim referuar si "antiserumi i kavieve") është një serum me spektër të gjerë, specifik për serogrupin dhe që mund të zbulojë të gjithë serotipet e njohura të virusit AHS.

Parimi i testit është ndërprerja e reagimit midis antigenit AHSV dhe antiserumit të kavieve me anë të një kampioni të serumit që do të testohet. Antitrupe AHSV në kampionin e serumit që do të testohet do të konkurrojnë me ato në antiserumin e kavieve duke çuar në reduktimin e ngjyrës së pritshme (pas shtimit të antitrupeve të bashkuar me enzima dhe të substratit). Serumet mund të testohen në një hollim të vetëm me raport 1 me 5 (testi i njollës) ose mund të titrohen (metoda e titrimit të serumeve) për të dhënë pikat e fundit të hollimit. Vlerat inhibuese më të larta se 50% mund të konsiderohen si pozitive.

Protokolli i testit të përshkruar më poshtë përdoret në laboratorin rajonal referencë për sëmundjen afrikane të kuajve në Pirbright, në Mbretërinë e Bashkuar.

1.1. Procedura e testimit

1.1.1. Përgatitja e pllakave

1.1.1.1. Pllakat ELISA vishen me antigenin AHSV të marrë nga kulturat e qelizave të infektuara dhe hollohen në bufer karbonati/bikarbonati me pH 9,6. Pllakat ELISA inkubohen për një natë në temperaturë 4 °C.

1.1.1.2. Pllakat lahen tre herë duke mbushur dhe zbrazur puset me kripë fosfat bufer (PBS), me pH 7, 2 deri në 7,4 dhe lihen të thahen në një letër absorbuese.

1.1.2. Puset e kontrollit

1.1.2.1. Titrohet serumi i kontrollit pozitiv në një seri hollimi dyfish nga 1:5 në 1:640, në gjithë kolonën 1 në bufer bllokues (me një solucion PBS që përmban 0,05 % (v/v) Tween-20, 5,0 % (w/v) qumësht pluhur të skremuar (Cadbury's Marvel™) dhe 1 % (v/v) serum gjedhi të rritur) për të arritur një vëllim përfundimtar prej 50 µl/pus.

1.1.2.2. Shtohen 50 µl nga serumi negativ i kontrollit në një hollim në raport 1:5 (10 µl serum + 40 µl bufer bllokues) në puset A dhe B të kolonës 2.

1.1.2.3. Në puset C dhe D të kolonës 2 (të bardhë) shtohet bufer bllokues në masën 100 µl.

1.1.2.4. Në puset E, F, G dhe H të kolonës 2 shtohet 50 µl bufer bllokues (kontrolli i kavieve).

1.1.3. Metoda e testimit me pikë:

1.1.3.1. Shtohet një sasi e holluar 1:5 e çdo serumi që testohet në buferin bllokues, për të dyfishuar puset e kolonave 3 deri në 12 (10 µl serum + 40 µl bufer bllokues).

ose

1.1.4. Metoda e titrimit të serumit

1.1.4.1. Përgatitet një seri hollimesh dyfishë e çdo kampioni që testohet (1:5 deri në 1:640) në bufer bllokues në tetë puset e një kolone të vetme nga 3 deri në 12.

më pas

1.1.5. Të shtohen 50 µl antiserum kaviesh, të holluara paraprakisht në bufer bllokues, në të gjitha puset përveç puseve të kontrolleve të bardhë të pllakës ELISA (në këtë fazë të gjitha puset përmbajnë një vëllim përfundimtar prej 100 µl).

1.1.5.1. Inkubohet për 1 orë në një përzierës orbital, në temperaturë 37°C.

1.1.5.2. Pllakat lahen tre herë dhe lihen të thahen si më parë.

1.1.5.3. Të shtohen në çdo pus 50 µl serum lepuri antikavie të konjuguara me peroksidazë rrepash (HRP), të holluara paraprakisht në bufer bllokues.

1.1.5.4. Inkubohet për 1 orë në një përzierës orbital, në temperaturë 37°C.

1.1.5.5. Pllakat lahen tre herë dhe lihen të thahen si më parë.

1.1.6. Kromogjen

Përgatitet solucioni i kromogjenit OPD (OPD = ortho-fenilenediamin) në përputhje me udhëzimet e prodhuesit (0,4 mg/ml në ujë steril të distiluar) menjëherë para përdorimit. Shtohet substrat (peroksid hidrogjeni = H₂O₂) për të arritur një përqendrim përfundimtar prej 0,05 % (v/v) (1:2000 nga një solucion H₂O₂ prej 30%). Shtohen 50 µl solucioni OPD në secilin pus dhe pllakat lihen në bankëprovë për 10 minuta në temperaturë ambienti. Ndalohej reaksioni duke shtuar 50 µl acid sulfurik 1 M (H₂SO₄) për pus.

1.1.7. Leximi

G	1:320	CC	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
H	1:640	CC	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
C-			= kontrolli negativ.									
C+			= kontrolli pozitiv.									
CC			= kontrolli i kavieve.									

SERUMET QË TESTOHEN

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
	C+		Serumet që testohen									
A	1:5	C-	1:5									1:5
B	1:10	C-	1:10									1:10
C	1:20	I bardhë	1:20									1:20
D	1:40	I bardhë	1:40									1:40
E	1:80	CC	1:80									1:80
F	1:160	CC	1:160									1:160
G	1:320	CC	1:320									1:320
H	1:640	CC	1:640									1:640
C-			= kontrolli negativ.									
C+			= kontrolli pozitiv.									
CC			= kontrolli i kavieve.									

2. ELISA INDIREKTE PËR ZBULIMIN E ANTITRUPAVE NDAJ VIRUSIT TË SËMUNDJES AFRIKANE TË KUAJVE (AHSV) (TEST I DETYRUESHËM)

Testi i përshkruar në vijim është në përputhje me përshkrimin e testit në Kreun 2.1.11 të OIE-së Manuali i standardeve për testet diagnostikuese dhe vaksinat, botimi i katërt, 2000.

Proteina e rikombinuar VP7 është përdorur si antigjen për të zbuluar praninë e antitropave të virusit AHS me një tregues të lartë të ndjeshmërisë dhe të specifikave. Avantazhet e tjera të kësaj proteine janë qëndrueshmëria dhe të qenit jo infektuese.

2.1. Procedura e testimit

2.1.1. Faza e ngurtë

2.1.1.1. Pllakat ELISA janë të veshura me proteinën e rikombinuar VP7 të AHSV-së së serotipit 4 të holluar në bufer karbonati/bikarbonati me pH 9,6. Pllakat inkubohen për një natë në temperaturë 4 °C.

2.1.1.2. Pllakat lahen pesë herë me ujë të distiluar që përmban 0,01 % (v/v) Tween 20 (solucion larës). Pllakat goditen lehtë në material absorbues për të larguar çdo mbetje të solucionit.

2.1.1.3. Pllakat bllokohen me kripë fosfat bufer (PBS) + 5 % (w/v) qumësht të skremuar (qumësht i skremuar në formë pluhuri Nestlé™), 200 µl/pus, për një orë në temperaturë 37 °C.

2.1.1.4. Hiqet solucioni bllokues dhe pllakat goditen lehtë në material absorbues.

2.1.2. Kampionët e testit

2.1.2.1. Kampionët e serumit që do të testohet si dhe serumet pozitive dhe negative të kontrollit, hollohen 1:25 në PBS + 5 % (w/v) qumësht të skremuar + 0,05 % (v/v) Tween 20, 100 µl për pus. Inkubohet për 1 orë në temperaturë 37°C.

Për provën e titrimit, përgatitet një seri hollimesh dyfishe duke filluar nga 1:25 (100 µl/pus), një serum për çdo kolonë të pllakës. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për kontrollet pozitive dhe negative. Inkubohet për 1 orë në temperaturë 37°C.

2.1.2.2. Pllakat lahen sipas përkrahimit në pikën 2.1.1.2.

2.1.3. Konjugati

2.1.3.1. Në çdo pus shtohen 100 µl peroksidazë rrepash (HRP) të konjuguara me gamaglobulinë kundër kuajve të holluar në PBS + 5 % qumësht + 0,05 % Tween 20, me pH 7,2. Inkubohet për 1 orë në temperaturë 37°C.

2.1.3.2. Pllakat lahen sipas përkrahimit në pikën 2.1.1.2.

2.1.4. Kromogjen/Substrat

2.1.4.1. Shtohen 200 µl solucion kromogjeni/substrati për pus (10 ml nga 80,6 mM DMAB (dimetil aminobenzaldehid) + 10 ml nga 1,56 mM MBTH (3-metil-2-benzo-tiazolin hidroklorid hidrazoni) + 5 µl H₂O₂)

Zhvillimi i ngjyrës ndërpritet duke shtuar 50 µl 3N H₂SO₄ pas afërsisht 5 deri në 10 minuta (para se kontrolli negativ të fillojë të ngjyroset).

Mund të përdoren gjithashtu edhe kromogjene të tjera si ABTS (2,2'-Azino-bis-[3-etilbenzotiazolin-6-acid sulfonik]), TMB (tetrametil benzidin), ose OPD (orto-penildiamin).

2.1.4.2. Pllakat lexohen në 600 nm (ose 620 nm).

2.2. Interpretimi i rezultateve

2.2.1. Llogaritet vlera kufi duke i shtuar 0,6 vlerës së kontrollit negativ (0,6 është devijimi standard i përftuar nga grupi me 30 serume negative).

2.2.2. Kampionët e testit që japin vlera absorbuese më të ulëta se ato kufi, konsiderohen negativë.

2.2.3. Kampionët e testit që japin vlera absorbuese më të larta se ato kufi + 0,15, konsiderohen pozitivë.

2.2.4. Kampionët e testit që japin vlera absorbuese mesatare janë të paqartë dhe për të konfirmuar rezultatin duhet përdorur një teknikë e dytë.

3. ELISA BLOKUESE PËR ZBULIMIN E ANTITRUPAVE NDAJ VIRUSIT TË SËMUNDJES AFRIKANE TË KUAJVE (AHSV) (TEST I DETYRUESHËM)

ELISA bllokuese synohet për të zbuluar antitropa AHSV specifike në serumet e të gjitha specieve të ndjeshme. VP7 është proteina kryesore antigjene e virusit AHSV, dhe ruhet brenda nëntë serotipeve. Meqenëse edhe antitropi monoklonal (Mab) drejtohet kundër VP7, prova do të japë një nivel të lartë ndjeshmërie dhe specifike. Gjithashtu, antigjeni rikombinues VP7 është tërësisht i padëmshëm dhe rrjedhimisht garanton një nivel të lartë sigurie.

Parimi i testit është ndërprerja e reaksionit midis proteinës rikombinuese VP7, si antigjen i lidhur me pllakën ELISA dhe antitropit të saj specifik monoklonal. Antitropi në serumet që testohen do të bllokojë reaksionin midis antigenit dhe antitropit monoklonal duke rezultuar në reduktimin e ngjyrës.

Testi i përshkruar në vijim kryhet në laboratorin referencë të Bashkimit Evropian për sëmundjen afrikane të kuajve në Algete, Spanjë.

3.1. Procedura e testimit

3.1.1. Pllakat ELISA

3.1.1.1. Pllakat ELISA vishen me proteinën e rikombinuar VP7 të AHSV-së së serotipit 4 të holluar në bufer karbonati/bikarbonati me pH 9,6. Pllakat inkubohen për një natë në temperaturë 4 °C.

3.1.1.2. Pllakat lahen pesë herë me kripë fosfat bufer (PBS) që përmban 0,05 % (v/v) Tween 20 (PBST).

3.1.1.3. Pllaka stabilizohet me anë të trajtimit me solucion stabilizues (në mënyrë që të mundësohet një ruajtje afatgjatë në temperaturë 4 °C pa humbje aktiviteti) dhe lihet të thahet në material absorbues.

3.1.2. Kampionët e testit dhe kontrollet

3.1.2.1.: Për ekzaminimin:: serumet që testohen dhe kontrollet hollohen në proporcion 1:10, drejtpërdrejtë në pllakën në PBST për të dhënë një vëllim përfundimtar prej 100 µl/pus. Inkubohet për 1 orë në temperaturë 37°C.

3.1.2.2.: Për titrimin: përgatitet një seri hollimesh dyfishë e serumeve që testohen dhe e kontrolleve pozitive (100 µl/pus) nga 1:10 në 1:1 280 në tetë puse. Kontrolli negativ testohet në hollim 1:10.

3.1.3. Konjugati

Në çdo pus shtohen 50 µl peroksidazë rrepa të paraholluar (HRP) dhe të konjuguar me Mab (antitropi monoklonal specifik për VP7) dhe përzihen me kujdes për të garantuar homogjenitetin. Inkubohen për 30 minuta në temperaturë 37°C.

3.1.4. Pllakat lahen pesë herë me PBST dhe lihen të thahen si më sipër.

3.1.5. Kromogjen/Substrat

Në çdo pus shtohen 100 µl solucion kromogjeni/substrati (1 ml ABTS (2,2'-Azino-bis-[3-etilbenzotiazolin-6-acid sulfonik]) 5 mg/ml + 9 ml bufer substrati (0,1 M fosfat-citrat me pH 4 me përmbajtje H₂O₂ prej 0,03 %) dhe inkubohen për 10 minuta në temperaturë ambiente. Zhvillimi i ngjyrës ndërpritet duke shtuar në çdo pus 100 µl tretësirë me 2 % (w/v) SDS (sulfat dodecil natriumi).

3.1.6. Leximi

Lexohet në 405 nm në një lexues ELISA.

3.2. Interpretimi i rezultateve

3.2.1. Verifikimi i provës

Testi është i vlefshëm kur densiteti optik (OD) i kontrollit negativ (NC) është më i lartë se 1,0 dhe OD i kontrollit pozitiv (PC) është më i ulët se 0,2.

3.2.2. Llogaritja kufi

Kufiri pozitiv = $NC - ((NC - PC) \times 0,3)$

Kufiri negativ = $NC - ((NC - PC) \times 0,2)$

Në këtë formulë, NC është OD e kontrollit negativ dhe PC është OD e kontrollit pozitiv.

3.2.3. Interpretimi i rezultateve

Kampionët me vlerë OD më të ulët se kufiri pozitiv duhet të konsiderohen pozitivë për antitruapat AHSV.

Kampionët me vlerë OD më të lartë se kufiri negativ duhet të konsiderohen si negativë për antitruapat AHSV.

Kampionët me vlerë OD midis këtyre dy vlerave duhet të konsiderohen të paqarta dhe kafshët duhet të rikampionohen pas dy deri në tre javësh.

SHTOJCA V

PJESA A

DIREKTIVA E SHFUQIZUAR BASHKË ME LISTËN E NDRYSHIMEVE VIJUESE

(përmendur në nenin 22)

Direktiva e Këshillit 90/426/KEE (Gazeta Zyrtare L 224, 18.8.1990, f. 42).	
Direktiva e Këshillit 90/425/KEE (Gazeta Zyrtare L 224, 18.8.1990, f. 29).	vetëm neni 15 paragrafi 3
Direktiva e Këshillit 91/496/KEE (Gazeta Zyrtare L 268, 24.9.1991, f. 56).	vetëm në lidhje me referencën në Direktivën 90/426/KEE në nenin 26, paragrafi 2
Vendimi i Komisionit 92/130/KEE (Gazeta Zyrtare L 47, 22.2.1992, f. 26).	
Direktiva e Këshillit 92/36/KEE (Gazeta Zyrtare L 157,	vetëm neni 1

10.6.1992, f. 28).	
Akti i Aderimit, 1994, shtojca I, pika V.E.I.A.3 (Gazeta Zyrtare L 241, 29.8.1994, f. 132).	
Vendimi i Komisionit 2001/298/KE (Gazeta Zyrtare L 102, 12.4.2001, f. 63).	vetëm në lidhje me referencën në Direktivën 90/426/KEE në nenin 1, paragrafi 1 dhe në shtojcën I, pika 2
Vendimi i Komisionit 2002/160/KE (Gazeta Zyrtare L 53, 23.2.2002, f. 37).	
Rregullorja e Këshillit nr. 806/2003 (KE) (Gazeta Zyrtare L 122, 16.5.2003, f. 1).	vetëm Shtojca III, pika 10
Akti i Aderimit, 2003, shtojca II, pika 6.B.I.16 (Gazeta Zyrtare L 236, 23.9.2003, f. 381).	
Direktivë e Këshillit 2004/68/KE (Gazeta Zyrtare L 139, 30.4.2004, f. 321).	vetëm neni 15
Direktivë e Këshillit 2006/104/KE (Gazeta Zyrtare L 363, 20.12.2006, f. 352).	vetëm Shtojca, pika I.2
Direktivë e Këshillit 2008/73/KE	vetëm neni 7

(Gazeta Zyrtare L 219,
14.8.2008, f. 40).

PJESA B

LISTA E AFATEVE KOHORE PËR TRANSPOZIM NË LEGJISLACIONIN E BRENDSHËM

(përmendur në nenin 22)

Direktiva	Afati për transpozimin
90/426/KEE	1 janar 1992
90/425/KEE	1 korrik 1992
91/496/KEE	1 korrik 1992
92/36/KEE	31 dhjetor 1992
2004/68/KE	19 nëntor 2005
2006/104/KE	1 janar 2007
2008/73/KE	1 janar 2010

SHTOJCA VI

TABELA E PËRPUTHSHMËRISË

Direktiva 90/426/KEE	Kjo direktivë
Neni 1	Neni 1
Neni 2, germat "a" dhe "b"	Neni 2, germat "a" dhe "b"
Neni 2, germa "c"	Neni 2, germa "c", pika II dhe III
Neni 2, germa "d" deri në "i"	Neni 2, germa "d" deri në "i"
Neni 3	Neni 3
Neni 4, paragrafi 1, 2 dhe 3	Neni 4, paragrafi 1, 2 dhe 3
Neni 4, paragrafi 4, pikat I dhe II	Neni 4, paragrafi 4, germat "a" dhe "b"

Neni 4, paragrafi 5, germa "a", ndarja e parë deri në ndarjen e gjashtë	Neni 4, paragrafi 5, germa "a", pikat I deri në VI
Neni 4, paragrafi 5, germa "b"	Neni 4, paragrafi 5, germa "b"
Neni 4, paragrafi 6, nënparagrafi i parë, ndarja e parë deri në ndarjen e tetë	Neni 4, paragrafi 6, nënparagrafi i parë, germa "a" deri në "h"
Neni 4, paragrafi 6, nënparagrafët e dytë dhe të tretë	Neni 4, paragrafi 6, nënparagrafët e dytë dhe të tretë
Neni 5, paragrafi 1	Neni 5, paragrafi 1
Neni 5 paragrafi 2 germa a	Neni 5 paragrafi 2, nënparagrafi i parë, germat "a" dhe "b"
Neni 5, paragrafi 2, germa "b"	Neni 5, paragrafi 2, nënparagrafi i dytë, germat "a" dhe "b"
Neni 5, paragrafi 2, germa "c"	Neni 5, paragrafi 3
Neni 5, paragrafi 2, germa "d"	Neni 5, paragrafi 4
Neni 5, paragrafi 3, germat "a" dhe "b"	Neni 5, paragrafi 5, germat "a" dhe "b"
Neni 5, paragrafi 3, germa "c", ndarja e parë dhe e dytë	Neni 5, paragrafi 5, germa "c", nënparagrafi i parë, pikat I dhe II
Neni 5, paragrafi 3, germa "c", ndarja e dytë, fjalia e fundit	Neni 5, paragrafi 5, germa "c", nënparagrafi i dytë
Neni 5, paragrafi 3, germat "d" dhe "e"	Neni 5, paragrafi 5, germat "d" dhe "e"
Neni 6	Neni 6
Neni 7	Neni 7
Neni 8, paragrafi 1, nënparagrafi i parë, ndarja e parë dhe e dytë	Neni 8, paragrafi 1, germat "a" dhe "b"
Neni 8, paragrafi 1, nënparagrafi i dytë	Neni 8, paragrafi 2
Neni 8, paragrafi 2	Neni 8, paragrafi 3
Neni 9	Neni 9

Neni 10	Neni 10
Neni 11, paragrafi 1	Neni 11
Neni 11, paragrafi 2	—
Neni 12	Neni 12
Neni 13	Neni 13
Neni 14	Neni 14
Neni 15	Neni 15
Neni 16, paragrafi 1, germa "a" deri në "f"	Neni 16, paragrafi 1, germa "a" deri në "f"
Neni 16, paragrafi 1, fjalia e fundit	—
Neni 16, paragrafi 2	Neni 16, paragrafi 2
Neni 17	Neni 18
Neni 18	Neni 17
Neni 19, pikat I deri në IV	Neni 19, germat "a" deri në "d"
Neni 22	—
Neni 23	Neni 20
Neni 24, paragrafët 1 dhe 2	Neni 21, paragrafët 1 dhe 2
Neni 24, paragrafi 3	—
Neni 25, paragrafët 1 dhe 2	Neni 21, paragrafët 1 dhe 3
Neni 26	—
Neni 27	—
—	Neni 22
—	Neni 23
Neni 28	Neni 24

Shtojca A	Shtojca I
Shtojca B	Shtojca II
Shtojca C	Shtojca III
Shtojca D	Shtojca IV
—	Shtojca V
—	Shtojca VI

-
1. Opinion i 22 prillit 2009 (ende i pabotuar në Gazetën Zyrtare).
 2. *Gazeta Zyrtare L 224, 18.8.1990, f. 42.*
 4. *Gazeta Zyrtare L 3, 5.1.2005, f. 1.*
 5. *Gazeta Zyrtare L 224, 18.8.1990, f. 29.*
 6. *Gazeta Zyrtare L 184, 17.7.1999, f. 23.*
 7. *Gazeta Zyrtare L 224, 18.8.1990, f. 55.*
 8. *Gazeta Zyrtare L 157, 10.6.1992, f. 19.*
 9. *Gazeta Zyrtare 121, 29.7.1964, f. 1977.*
 10. *Gazeta Zyrtare L 31, 1.2.2002, f. 1.*
 11. Ky vërtetim nuk kërkohet në rastin e një marrëveshjeje bilaterale në përputhje me nenin 6 të Direktivës 2009/156/KE.
 12. I vlefshëm për 10 ditë.
 13. Të fshihen referencat e pavlefshme.
 14. Data e vaksinimit duhet të shënohet në pasaportë.
 15. Ky vërtetim nuk i përjashton transportuesit nga detyrimet e tyre në përputhje me dispozitat e zbatueshme të BE-së në veçanti për sa i përket përshtatshmërisë së kafshëve që do të transportohen.
 16. Emri me germa të mëdha dhe kapaciteti.
-